



DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Procesverbal

Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale me qytetarë i mbajtur më 22/03/2024

Takimi filloi në orën 15:18, në sallën e Kuvendit Komunal.

Takimin e hapi dhe e kryesoi **z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.**

Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (rreth 15 - bashkëngjitur lista e pjesëmarrësve), përfaqësues të kompanisë projektuese (Operatori Ekonomik) dhe zyrtarë komunal.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e hapi takimin duke përshëndetur të pranishmit dhe duke ju dëshiruar mirëseardhje, ndër të tjera theksoi arsyen për mbajtjen e këtij takimi.

Ashtu siç edhe jeni të informuar, në këtë takim si temë është paraparë:

➤ **Plani Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale.**

Të nderuar të pranishëm sipas Vendimit për vënie në shqyrtim publik të Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës lidhur me zhvillimin e këtij projekti, hapjen e debatit publik po e realizojmë sot dhe ju falënderoj të gjithëve për kohën tuaj.

Më lejoni që fjalën të ia kaloj përfaqësueses së kompanisë projektuese që të prezantoj draft Planin Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale, pastaj do ta hapet debati nga i cili do të marrim me seriozitet vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja në mënyrë që ta miratojmë formën më të mirë të Planit Rregullues për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës.

Urdhëroni, fjala për ju.

znj. Valesa Jahmurati, filloi prenazntimin;

-Sipërfaqja e planit rregullues së Zonës Industriale përfshin një sipërfaqe prej 61.7 ha, ka një pozitë të volitshme gjeografike në raport me qytetin, fshatrat dhe vendet përreth. Rrjeti rrugor është i varfër, përveç rrugës kresore. Rrjeti rrugor i propozuar është bërë për të ofruar zgjedhje. Pjesa me ngjyrë të verdhë paraqet pronën publike të Komunës, pjesa me ngjyrë të portokalltë paraqet parcelat që janë në kontest gjyqësor dhe parcelat me ngjyrë kafe janë pronë private.

Plani i parcelimit: hapësirat gjelbëruese, zona e gjelbërt i dedikohet gjelbërimit, pjesa me të verdhë qendër rekreative. Zona është ndarë në : publike, private dhe në kontest gjyqësor. Veprimtaritë që janë planifikuar për këtë zonë i takojnë llojeve: prodhime industriale (industri e lehtë, e industri e rëndë/e lëndës së parë dhe industri e lehtë/ e rëndë), servise, gastronomi,

prodhime zejtare, shkollë profesionale, shërbime plotësuese dhe qendër sportive dhe rekreative. Pra, ky është draft projekti jonë për Zonën Industriale.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, merr fjalën;

-Falenderon kompaninë projektuese për prezentimin e këtij plan dhe jep hapësirë për pyetje nga pjesëmarrësit.

z. Arton Kajtazi, parashtroi pyetjet si në vijim;

-Sa hyrje do të ketë Zona Industriale?

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqarim parafolësit, theksoi;

-Për arsye se parcelat janë në kontest gjyqësor, deri sa të fitohet pronësia mbeten tri hyrje momentale.

z. Arton Kajtazi, parashtroi pyetjen tjetër;

-Si do të sistemohen sipërfaqet e parcelave për bizneset?

-Veçanërishtë industria e lehtë?

znj. Valesa Jahmurati, u përgjigj;

-2500m²-10.000 m² janë standardet të cilat mund të kalohen, ndësa për industrinë e lehtë mbi 2500 m².

Si përfundim, **z. Leutrim Krasniqi**, potencoi meqenëse nuk ka të pranishëm tjerë që kanë kërkuar fjalën, falënderoj të gjithëve për prezencën dhe për kontributin e dhënë në këtë proces. Takimin po e përmbylлим. Gjithë të mirat!

Takimi përfundoi në ora 15:48.

Procesverbalin e mbajti,

Blerina Zeka

**Podujevë,
22/03/2024**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat publik me qytetarë, për vënienë në shqyrtim publik të Projekt Dokumentit të Planit
Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës / 22.03.2024

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	ARTON RAJTAZI	Podujevë		
2	Avni Sejiri	Podujevë		
3	Jehona Ajrovi	Podujevë		
4	Hamide Bahitiri	Gllamnik		
5	Teuta Prähmani	Dumicë		
6	Diellza Rama	Podujevë		
7	Genç Gashi	Podujevë		
8	LIRIDONA PRAHMANI	Podujevë		
9	Shqipdon Rushiti	Podujevë		
10	FIDAN RESTELICA	PODUEVË		
11	FATON TURKATI	PRISHTINË		
12	VALGESA JANUJENI	PRISHTINË		
13	BLERINA ZEKA	PODUEVË		
14	Donjeta Fazliu	Podujevë		
15	BESHNIK MURATI	Podujevë		
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				

24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				

Podujevě

22.03.2024